Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0037

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Nika PrO- Ing" Sh.P.K kundër njoftimit për dhënie të kontratës të një aktiviteti të prokurimit të Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverise dhe IRK", me nr. të prokurimit: "214- 23-11743-2-3-6", me 29/03/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K me nr. 2024/37, kurse vendimi i AK Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverise dhe IRK", me nr. të prokurimit: "214- 23-11743-2-3-6", mbetet në fuqi.

2. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.11.2023, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverise dhe IRK", me nr. të prokurimit: "214- 23-11743-2-3-6". Ndërsa me datën 22.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate "Lurn" Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës**:** 9,616.50 €.

Me 26.12.2023, “Nika PrO- Ing" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 28.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Nika PrO- Ing" SH.P.K me nr. 37/2024 për lidhur me aktivitetin “Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverise dhe IRK”, me nr. të prokurimit: "214- 23-11743-2-3-6".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

1. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Nika PrO- Ing" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se “Pretendimet e AK-se për eliminimin tone nuk qëndrojnë pasi ne kemi ofruar një kontrate te ndërtimit - Ndërtimi i Qendrës Familjare ne Gjilan me OJQ Chatar Charity nuk është e natyrës se njëjtë NUK qëndron sepse kompania jone ka kryer me sukses kontratën e ngjashme dhe te natyrës se njëjtë ku kemi kryer punë elektrike te gjithë objektit me tenderin ne fjale duke filluar prej instalimeve te energjisë elektrike dhe pune te tjera elektrike.”

Pretendimi i dytë (II): “Ne si OE i plotësojmë kushtet për te fituare këtë tender pasi jemi oferta me e lire me çmim. Duke u bazuar ne to gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontrate OE i cili ka qene me çmim me te larte. Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FTD-se dhe te njoftimit për kontrate, nuk jemi shpallur fitues te këtij tenderi por po shihet se qëllimi AK-se është qe ne mos te shpallemi fitues te këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operator& ekonomik ne mënyrë te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe Gjate udhëheqjes se aktiviteteve to prokurimit, to gjitha autoritetet kontraktuese do to sigurojnë; qe (vi) qe tenderi i zgjedhur to përputhet me to gjitha aspektet përmbajtjesore to kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 to LPP-se edhe pse autoritetet kontraktuese janë to obliguar qe to sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike to përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 to LPP-se. Autoriteti kontraktues duhet to këtë ne konsiderate edhe nenin 1 to LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është to siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me to drejte to shfrytëzimit to fondeve publike, burimeve publike si dhe to gjitha fondeve dhe burimeve to tjera to autoriteteve kontraktuese ne Kosove. Dëshmia e punëve to kryera janë të bashkangjitura ne ankesë.”

2. Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:

“Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 1) Pretendimi i tenderuesit ankues NIKA Pro-lng SH.P.K., Ferizaj, se Autoritetin Kontraktues, ka shkelur nenin 1 i LPP-së (Qëllimi) është i pabazuar, sepse gjatë vlerësimit Autoriteti kontraktues e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet lë prokurimit, si është paraparë në nenin I të LPP -së, citojmë :1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publiko, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen. procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat. operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese. koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen. në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. 2.Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që. vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 3.Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit. duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Deklarimi i tenderuesit ankues se vlerësimi nga AK është jo i drejte dhe eliminimi nga aktiviteti i prokurimit të tenderuesit Tenderuesi NIKA Pro-Ing SH.P.K., Ferizaj, është shkelur neni 1 i LPP-së është i pa bazuar sepse AK përkundrazi c ka shpallur fitues tenderuesin i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm, me këtë e ka respektuar qëllimin qe rrjedh nga ky Nen. 2.Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 6) Pretendimi i tenderuesit ankues NIKA Pro-Ing SH.P.K., Ferizaj, se AK me rastin e vlerësimit të këtij aktiviteti lë prokurimit, ka shkelur Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, ky konstatim nuk qëndron, sepse me rastin e vlerësimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues, Tenderi tuaj e ka vlerësuar me kujdes dhe e ka refuzuar, sepse gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit Tuaj, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se ju nuk keni dorëzuar dëshmi në pajtueshmëri me kërkesën te kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 6 të LPP-së, sepse AK me këtë veprim duke e shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ka respektuar këtë Nen dhe siguron që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 3.Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7) Pretendimi i tenderuesit ankues NIKA Pro-Ing SII.P.K., Ferizaj., thotë se AK me rastin e vlerësimit të tenderëve, ka shkelur Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, është i pabazuar, sepse me rastin e vlerësimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues Juve ju ka eliminuar, pasi që nuk keni dorëzuar tender të përgjegjshëm. Nuk keni dorëzuar dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me kurrfarë diskriminimi dhe me shkelje të Nenit 7 të LPP-së. Me shpalljen fitues, tenderuesin c përgjegjshëm, "Lurn” TSA Sh.P.K., i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara në Dosje të tenderit dhe në Njoftimin për kontratë, AK nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së tij,

andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 7 të LPP-së. 4.Përgjigje në pretendimin e lartë çekur (Neni 59) Pretendimi i tenderuesit ankues NIKA Pro-Ing Sh.P.K., Ferizaj., thotë se AK ka shkelur nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, kur na ka eliminuar neve nga konkurrenca si tenderues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët, Autoriteti Kontraktues, konstaton edhe një here së nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit, sepse AK gjatë vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet lë prokurimit ju ka përmbajtur dhe zbatuar nenin 59 par, 4 të LPP-së, citojmë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshmen vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin c kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju kemi njoftuar se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar: Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të I.PP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Arsyetim Tenderi juaj është refuzuar, sepse gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit Tuaj, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk keni dorëzuar dëshmi të mjaftueshme, si është kërkuar te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD) në Dosje të tenderit (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kapaciteti teknik dhe profesional), nr. i nenit 9.1 & 9.2 pika 2: 1 .Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë se paku një kontratë të ngjashme, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Dëshmitë: 1. Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kërkuar (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referencë ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve. Ju ne tenderin tuaj keni dorëzuar një kontratë për Ndërtim me O.J.Q Qatar Charity kontratë e cila nuk është e natyrës çfarë ne kemi kërkuar, sepse procedura e këtij aktiviteti është shërbim (2-3-6) e jo punë ndërtimore (45) 5-3-6 prandaj nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj nuk ka kaluar në vlerësimin e mëtutjeshëm. 5. Përgjigje në pretendimin c lartë cekur (Neni 60) Pretendim i tenderuesit ankues (Nika Pro-lng SH.P.K., Ferizaj), se nuk është zbatuar si duhet Nenin 60 të LPP-së me rastin c vlerësimit të tenderëve (Kriteret për Dhënien e Kontratës) nuk është i bazuar 17 sepse është respektuar ky nen, ku kërkohet (citojmë): LPP në nenin 60 paragrafi l. dhe nen paragrafin 1.1 përcakton: 7.Autoriteti Kontraktues do ti jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët: Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne pajtueshmëri me nenin 60, duke e shpallur fitues tenderuesin "LURN" Sh.P.K., i cili e ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët. 6 Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 69) Pretendimi i tenderuesit ankues NIKA Pro-Ing Sh.P.K., Ferizaj., thotë se AK ka shkelur nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, nuk është i bazuar sepse tenderi i juaj është vlerësuar me kujdes, është i papërgjegjshëm pasi nuk keni dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme, siç është kërkuar në pajtueshmëri me Nenin 69 të LPP-së Njoftimin për Kontratë, Dosje të Tenderit. 7. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 72) Pretendim i tenderuesit ankues (NIKA Pro-lng SH.P.K., Ferizaj), se nuk është zbatuar si duhet Nenin 72 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Dokumentacioni dhe informacioni shtese) nuk është i bazuar, sepse është respektuar ky nen, sepse me rastin e dorëzimit të tenderit tuaj nuk e keni dorëzuar si është kërkuar:2. Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kërkuar (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar tre vjeçare), duke bashkëngjitur referencë ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve. Ku në këto raste është dhënë sqarim si të veprohet gjatë vlerësimit të tenderëve në Udhëzuesin Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, si vijon: 10.Sqarimi i tenderëve gjatë procesit lë vlerësimit të tenderëve. 10.1Shembull e mëposhtëm nuk janë te

vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Meqenëse nuk është dorëzuar Lista e kontratave të realizuara, nuk ka mundur AK të kërkoj sqarime sepse nuk ka pasur informata cilat dëshmi ti kërkoj, andaj nuk kemi të bëjë me shkelje lë Nenit 72 të LPP-së. ”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 37/2024, ndërsa me datë 15.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/37 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

3. Lidhur me pretendimet e OE “Nika PrO- Ing" SH.P.K - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0037 kanë vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): *“*Pretendimi ankimor ka te beje me arsyetimin e eliminimit te OE ankues, ku Autoriteti Kontraktues, përmes letrës standarde ka eliminuar OE “Nika Pro-Ing” Sh.P.K., ku ka përcaktuar qe nuk është prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën e përcaktuar ne piken III.4, te FTD-se, ku AK - MPB ka kërkuar: Kapaciteti teknik dhe profesional: 2. Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë se paku një kontratë të ngjashme, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kërkuar (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referencë ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve. OE ankues ne oferte ka prezantuar kontratën te lidhur me një OJQ “Qatar Charity”, ne prani te noterit me titull: “Ndërtimi e objektit te qendrës se mjekësisë familjare”. Eksperti shqyrtues sqaron se lende e kësaj procedure te prokurimit ka te beje me demontim, zhvendosje, instalim dhe konfigurim te gjeratoreve ne ndërtesat e Qeverise dhe Institucioneve të Republikës se Kosovës. Kontrata e lidhur me QATAR, nuk ka te beje me këtë procedure te prokurimit megjithëse atë OE ankues bashkangjitur ne ankese ka prezantuar një paramase – parallogari ku disa nga pozicionet e përshkruara ne ta te ndërlidhur me procedurën e prokurimit. Bazuar ne dëshminë e bashkangjitur ne ankese-paramasen, eksperti shqyrtues propozon qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne rivlerësim me qellim qe Autoriteti Kontraktues konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkojë

sqarim nga kontraktuesi QATAR, me qe OE ankues pretendon se e njëjta paramase është realizuar me sukses nga i njëjti kontraktues ne mënyrë qe AK, te vërtetoj nëse paramasa e njëjtë përkatësisht pozicionet e përshkruara ne te janë realizuar nga OE ankues".

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raportet e ekspertit shqyrtues, janë hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në kontest me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik. Si rrjedhojë, Paneli shqyrtues në këtë rast nuk mund t'i mbështet rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilat nuk kanë as edhe një bazë ligjore dhe provë për ta kthyer aktivitetin e prokurimit publik në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues për ankesën e parashtruar me numër protokolli: 2024/0037, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues, të hartuar nga eksperti me kërkesën panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të operatori ekonomik ankues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverise dhe IRK", me nr. të prokurimit: "214- 23-11743-2-3-6", të autoritetit kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme. Paneli vëren se eksperti shqyrtues nuk ka analizuar të gjitha shkresa e lëndës përfshirë edhe përgjigjen e autoritetit kontraktues në kërkesën për rishqyrtim ndaj operatorit ekonomik ankues.

Ankues atakon arsyen e eliminimit te tij/saj, ku sipas Autoriteti Kontraktues, ankuesi nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën e përcaktuar ne piken III.4, te FTD-se, ku AK - MPB ka kërkuar: Kapaciteti teknik dhe profesional duke potencuar se OE ankues ne oferte ka prezantuar kontratën te lidhur me një OJQ "Qatar Charity", "Ndërtimi e objektit te qendrës se mjekësisë familjare" që nuk është e natyrës që është kërkuar. Eksperti shqyrtues sqaron se lende e kësaj procedure te prokurimit ka te beje me demontim, zhvendosje, instalim dhe konfigurim te gjeratoreve ne ndërtesat e Qeverise dhe Institucioneve të Republikës se Kosovës. Kontrata e lidhur me QATAR, nuk ka te beje me këtë procedure te prokurimit megjithëse atë OE ankues bashkangjitur ne ankese ka prezantuar një paramase – parallogari ku disa nga pozicionet e përshkruara ne ta te ndërlidhur me procedurën e prokurimit. Bazuar ne dëshminë e bashkangjitur ne ankese-paramasen, eksperti shqyrtues propozon qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne

rivlerësim me qellim qe Autoriteti Kontraktues konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkojë sqarim nga kontraktuesi QATAR, me qe OE ankues pretendon se e njëjta paramase është realizuar me sukses nga i njëjti kontraktues ne mënyrë qe AK, te vërtetoj nëse paramasa e njëjtë përkatësisht pozicionet e përshkruara ne te janë realizuar nga OE ankues. Për Panelin Shqyrtues ky konstatim i ekspertit përveç që është kontradiktor dhe bien ndesh me vetveten i njëjti nuk është as konform dispozitave ligjore. Neni 72 i LPP, dhe Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik e definon mjaftë qartë se në cilat raste mund të aplikohen sqarimet shtesë. Andaj, e mbështet vendimin e autoritetit kontraktues rreth arsyes së eliminimit të ankuesit duke u bazuar edhe në opinionin Nr. 11 të KRPP, i cili citon: "Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këtë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Kështu që, paneli shqyrtues konstaton se veprimet e AK janë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë oferta e OE ankues është refuzuar.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore të ankuesit në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në rivlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Vlenë të potencohet se autoriteti kontraktues është përgjegjës së konform nenit 24.2 të LPP, që aktivitetet e prokurimit ti zhvilloj konform dispozitave ligjore për prokurim publik që janë në fuqi. Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..."

Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 dhe par 4 lidhur me paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: